

SI MUND T'I MBRONI KAFSHË TUAJA?

Pajtueshmëria me legjislacionin veterinar dhe masat e mira të biosigurisë, identifikimi i kafshëve, kontrolli i lëvizjes dhe karantina janë mënyra më e besueshme për të parandaluar hyrjen e virusit të PPR në fermat e dhive dhe deleve.

- Zbatimi i rreptë i masave të biosigurisë;
- Blerja e kafshëve vetëm nga burime të regjistruara dhe të shoqëruara me certifikatë shëndetësore;
- Identifikimi dhe regjistrimi i kafshëve në fermën tuaj;
- Mbajtja e higjienës përmes pastrimit dhe dezinfektimit të rregullt të fermës dhe pajisjeve;
- Përdorni vetëm pajisjet tuaja në fermë;
- Shmangni kontaktin e kafshëve tuaja me kafshë të tjera;
- Kufizoni hyrjen e mjeteve dhe vizitorëve në fermën tuaj.

Ju mund të keni të drejtë për kompensim për humbjet tuaja, nëse keni përmbushur të gjitha kërkesat ligjore, përfshirë identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve, raportimin e saktë të lëvizjeve të tyre dhe respektimin e detyrimeve të tjera të zbatueshme.

RAPORTONI SHENJAT E MURTAJËS SË RUMINANTËVE TË VEGJËL MBANI BIOSIGURINË TË FORTË.

MBROJINI KAFSHËT TUAJA!



MURTAJA E RUMINANTËVE TË VEGJËL

ÇFARË ËSHTË MURTAJA E RUMINANTËVE TË VEGJËL (PPR)?

Murtaja e ruminantëve të vegjël është sëmundje virale shumë ngjitëse dhe serioze që prek delet dhe dhitë, e cila mund të çojë në ngordhshmëri të lartë.

NDALONI MURTAJËN
TE RUMINANTËT E VEGJËL



 **0800 33 66**



RAPORTIMI I MENJËHERSHËM ËSHTË THELBËSOR

Kjo sëmundje mund të shkaktojë pasoja të mëdha dhe humbje ekonomike për fermerët për shkak të ngordhshmërisë, uljes së prodhimit të qumështit, cilësisë së dobët të lëkurës dhe leshit, si dhe kufizimeve tregtare.

A SËMUREN NJERËZIT?

Njerëzit nuk sëmuren nga murtaja e ruminantëve të vegjël, por mund të luajnë rol në përhapjen e sëmundjes. Roli juaj në parandalim dhe zbulim të hershëm është shumë i rëndësishëm!

MËNYRAT E TRANSMETIMIT MURTAJA E RUMINANTËVE TË VEGJËL (PPR) :




- Kontakti i drejtpërdrejtë dhe i afërt ndërmjet kafshëve të infektuara dhe atyre të ndjeshme;
- Thithja e grimcave të lëshuara në ajër kur kafshët e infektuara kolliten dhe teshtijnë;
- Transmetimi indirekt përmes ujit, ushqimit apo shtrojave të kontaminuara nga lotët, sekrecionet nazale, kollitjet dhe jashtëqitjet e kafshëve të infektuara.



**Nëse vini re këto simptoma, ju lutemi telefononi në numrin e gjelbër
08003366 të Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.**

CILAT JANË SHENJAT KLINIKE TË SËMUNDJES ?

Simptomat klinike mund të variojnë nga të lehta deri në të rënda, në varësi të kafshës, statusit imunitar, moshës dhe racës, si dhe shtamit të virusit. Shenjat klinike të murtajes së ruminantëve të vegjël mund të jenë:



Është shumë e rëndësishme që menjëherë t'i raportoni veterinerit tuaj çdo ndryshim në gjendjen shëndetësore të deleve ose dhive tuaja. Zbulimi i hershëm do të parandalojë përhapjen e gjerë të sëmundjes, do të shpëtojë shumë ruminantë të vegjël dhe sëmundja mund të kontrollohet në mënyrë më efektive.